



**MITROVICA**  
KOMPANIA UJËSJELLËSI RAJONAL SH.A.  
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.  
KOMPANIJA REGIONALNI VODOVOD D.D.

Duke u bazuar në nenin 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212 si dhe Udhëzimin Administrativ Nr.07/2017, shpallë:

## KONKURS

(Për plotësimin e vendit të lirë të punës, punë provuese 6)

### I. Një(1) Zyrtar/e për burime (resurse) njerëzore

#### **Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:**

- Të jetë i/e aftë që me orar të plotë dhe pa kufizime të kryej detyrat e punës,
- Organizon, koordinon dhe udhëheq me Shërbimin e Administratës, resurseve njerëzore dhe Personelin,
- Administrimin dhe mirëmbajtjen e dosjeve të të punësuarve në nivel të Kompanisë duke bartur çdo ndryshim si: kontratat, vendimet, aktvendimet, sistemimet, vlerësimet etj, që rrjedhin nga mardhënja e punës,
- Kujdeset për azhurnimin dhe mirëmbajtjen e librit amzës (në elektronikë) të të punësuarve në ndërmarrje,
- Kujdeset për kryerjen e të gjitha punëve që kanë të bëjnë me formimin e evidencave përkatëse për punëtorë, bënë paraqitjen dhe ç'lajmërimin e punëtorëve, përgaditë raportet statistikore për resurset njerëzore të kompanisë dhe përgaditë të dhënat për përpunimin kompjuterik mbi evidencat për punëtorë dhe bënë politiken e menaxhimit të mbrojtjes së të dhënave,
- Në koordinim me departamentet bënë hartimin e planit vjetor për pushimet vjetore dhe paraqet nevojat për kuadrot e reja,
- Kujdeset dhe mban evidencën e librit vjetor të pushimeve vjetore, përgaditë aktvendimet për këto pushime në nivel të Kompanisë dhe i ekspediton ato,
- Me kërkesë të punëtorëve, përgaditë vërtetimet dhe lëshon dëshmi të tjera që burojnë nga të drejtat dhe detyrimet nga mardhënia e punës dhe për përvojën e punës,
- Me kërkesë të punëtorëve, u mundëson atyre të kenë qasje në dosjen personale,
- Kujdeset për kohën e skadimit të kontratave të punësuarve, dhe kohën e përmbushjes së kushteve për pensionim të punëtorëve për të cilat njofton Udhëheqësin, për procedim të mëtutjeshëm,
- Mban evidencën për mungesën nga puna të punësuarve në nivel të Kompanisë në baza ditore sipas raporteve të pranuar nga Menaxherët, në bazë të të cilave raporton në baza ditore, javore dhe mujore,
- Në bashkëpunim me Menaxheret dhe Drejtorët e Departamenteve përpilon analiza dhe jep rekomandime për masat lidhur me zhvillimin e kapaciteteve si dhe organizon trajnime për stafin,
- Sigurohet që së paku një herë në vit të bëhet vlerësimi i performances të secilit punëtor në kompani,
- Bënë kalkulimin e pagave të stafit të KRUM-së,
- Përgaditë raporte të nevojshme nga fushëveprimtaria e burimeve njerëzore,
- Kryen edhe punët tjera në suaza të përgatitjes profesionale dhe në bazë Urdhëresave të Sekretarit/es të Kompanisë,

- Për punën që kryen i përgjigjet Sekretarit/es së Kompanisë.

Kushtet për punësim(edukimi i kërkuar):

-Përgaditja profesionale: Baçelor në Fakultetin Juridik/Ekonomik apo përgaditja e lartë profesionale në fushën e Resurseve (burimeve) njerëzore.

-Përvoja e punës: Së paku 2 vite përvojë pune,

Kushtet të veçanta:

- Përvoja në fushën e Resurseve njerëzore (e preferueshme),
- Njohja e Ligjit të Punës dhe legjislacionit përkatës për Resurset njerëzore,
- Njohja e gjuhës angleze e preferueshme,
- Aftësi të shkëlqyeshme komunikimi dhe bashkëpunimi.

Paga bazë do të jetë 561.65 Euro sipas Rregullores mbi ndarjen e të ardhurave.

Dokumentet e kompletuara të cilat duhet të përfshijnë letrën përcjellëse, biografin tuaj (CV-në), kopjen e diplomës përkatëse e noterizuar, referencat dhe certifikatat e trajnimeve, të mos jetë nën hetime dhe i dënuar apo i dënuar me kusht, kopje e letërnjoftimit, dëshmi mbi përvojën e punës (trusti pensional) etj.

Dokumentacioni dorëzohet i fotokopjuar dhe i njëjti nuk u kthehet aplikantëve.

Aplikacionet merren dhe i tërë dokumentacioni i kompletuar dorëzohet në Drejtorin e KRUM-së Rr.,Liqeni,,Suhodoll-Mitrovicë ose në formë elektronike në email- adresën [burimet.njerzore@kru-mitrovica](mailto:burimet.njerzore@kru-mitrovica)

Aplikacionet mund ti merrni edhe në ueb- faqen e kompanisë.

Dokumentet që nuk janë të kompletuara sipas konkursit nuk do të shqyrtohen.

Konkursi do të jetë i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mjetet e informimit.

Kompania Rajonale Ujësjiellësi “Mitrovica” Sh.A. në Mitrovicë inkurajon kandidatet femra , kandidatet nga grupet minoritare si dhe personat me aftësi të kufizuar të aplikojnë.

KRU ”Mitrovica” Sh. A. Mitrovicë